



Për: Z. Naim Qelaj
Avokat i Popullit

Nga: Ehat Miftaraj
Drejtore Ekzekutive i Institutit të Kosovës për Drejtësi

Lënda: Kërkesë për fillimin e hetimeve për shkelje të të drejtave të njeriut dhe inicim në Gjykatën Kushtetuese të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik

Data: 6 Janar 2023

I nderuari z. Qelaj,

Uroj që kjo letër të ju gjejë mirë.

Më lejoni të ju informoj se Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) më 22 dhjetor 2022 ka publikuar analizën “*Pagat në Sektorin Publik*”, të cilën analizë e gjeni të bashkangjitur. Objekt i kësaj analize është Ligji Nr.08/L-196 për Paga në Sektorin Publik (Tutje: *Ligji*), i cili është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe është shpallur në Gazetën Zyrtare me 5 Janar 2023. Kjo analizë, i është dërguar deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës para miratimit të Ligjit, por se sugjerimet nuk janë marrë parasysh. Kështu, përkundër faktit se kjo analizë i referohet “Projektligjit”, gjetjet e së njëjtës janë relevante për Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, për të cilin kërkohet hetimi dhe procedimi për vlerësim të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese.

Në këtë analizë, gjetjet e IKD tregojnë për probleme serioze kushtetuese të Ligji Nr.08/L-196 për Paga në Sektorin Publik.

IKD ka gjetur se Ligji cenon sigurinë juridike të nëpunësve të sektorit publik, duke mos përcaktuar vlerën monetare të koeficientëve. Sa i përket uljes së pagave, Ligji ka përcaktuar rregulla adekuate për mbrojtjen e nëpunësve nga ulja e pagave. Por, IKD ka gjetur se Ligji i mbron këto rregulla vetëm për të ardhmen, por se nuk i aplikon për të kaluarën. Kjo pasi Ligji në fjalë nuk ka një zgjidhje adekuate në raport me nëpunësit e sektorit publik të cilët ndikohen negativisht nga ky Ligj.

Ndonëse ky Ligj nuk ka përcaktuar vlerën monetare të koeficientit, nga fryma e përgjithshme e tij (si psh. përcaktimi i dispozitave mbi shtesën transitorë) dhe nga disa prej raportimeve, shihet një tendencë për uljen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Me këtë rast, IKD tërheq vëmendjen se ulja e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në këtë situatë është në kundërshtim me kërkesat që rrjedhin nga Aktgjykimi nr. KO219/19 dhe në kundërshtim me opinionet e

Komisionit të Venecias, të cilat kanë krijuar tashmë praktikë dhe standard ndërkombëtar, në raport me pagat në sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Në disa raste të tjera, IKD ka gjetur se Ligji në fjalë përmban dispozita të cilat paraqesin trajtim të pabarabartë të nëpunësve të sektorit publik, aspekt ky që paraqet shkelje të nenit 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Po ashtu, IKD ka gjetur se Ligji përmban dispozita të cilat cenojnë pavarësinë funksionale të sistemit të drejtësisë, i cili cenim paraqet shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Me qëllim të mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve, reagimi i Avokatit të Popullit në këtë situatë është i domosdoshëm. Përmes kësaj letre, IKD kërkon nga Avokati i Popullit që ta trajtojë këtë çështje dhe në përputhje me kompetencat kushtetuese dhe ligjore të iniciojë Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese.

Krahas kësaj shkrese, ju lutem gjeni bashkangjitur edhe analizën e IKD “*Pagat në Sektorin Publik*”. Mbetemi në dispozicionin tuaj nëse gjatë fazës së trajtimit të kësaj çështje keni nevojë për të dhëna shtesë.

Me respekt,

Ehat Miftaraj
Drejtor Ekzekutiv
Instituti i Kosovës për Drejtësi